

Nr. .... Prot  
Lutemi referoni këtë numër në përgjigje

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_. 2022

## Lënda : Kthim përgjigje

Në përgjigje të kërkesës tuaj dt 21.06.2022 ardhur në postën elektronike

### Pyetja

Persa i perket kontrates qe KESH me paralajmeron se do ma jape te shkurtuar, ju bej me dije se ne fillim te cdo kontrate ndodhen firmetaret te cilet jane perfaqesuesit e paleve qe kane firmosur marrevshjen.

Pas kesaj vijne kushtet e kontrates te cilat tregojne se si veprohet me kontraten, a ju dorezohet paleve te treta? A ka pjese qe duhet te rrine sekrete, etj.

Te gjitha keto, ju duhet ti citoni dhe ti ilustroni me patjeter nepermjet faqeve te kontrates qe te pasqyrohen sakte ne media sepse ne fillim ajo e ka me patjeter se kontrata ka keto faqe sekrete, apo keto faqe ku cilesohet se cfare lloj kontrate eshte kjo marrevshje dhe pas kesaj mund te me jepni faqet qe lejohen per median nese ka sekrete.

### Përgjigje dt.27.06.2022

KESH sh.a. është vënë në dijeni të kërkesës për informacionin nëpërmjet e-mail të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, për ti dhënë përgjigje pikës 6-të të saj, dhe kontketisht kërkesës me objekt *"Kopje të kontratës së firmosur me kompaninë apo entitetin me të cilin është firmosur kontrata"*.

Pasi është vënë në dijeni të kërimit, nisur nga fakti se akti që kërkohet është kontratë dhe si e tillë është e lidhur mes disa palëve, ju bëjme me dije se në bazë të parashikimeve kontraktore, KESH sh.a duhet të njoftoj edhe palët e tjera për dhenien e kontratës e më pas do të bëjë të mundur dërgimin e kontratës për kërkuesin.

Gjithashtu ju bëjme me dije se, për çështje të sigurisë së operimit dhe asetit disa elemente teknike pjesë tenkike përbërese e kontrates nuk do të mund të bëhen me dije për të tretët, duke dhënë kopje.

Në link më poshtë, po ju percjell kontratën e lidhur mes KESH dhe Exelerate & Renco për asetin e përkohshëm termik.

<https://we.tl/t-XCEWu035iu>

Në këtë material mungojnë vetëm anekset e të dhënave teknike për pajisjet gjeneruese, të cilat lidhen me sigurinë e operimit të këtyre mjeteve dhe dokumente tip apo reference që do të përdoren për fazat e zbatimit të kontratës për tu plotësuar nga palet, Shtojca.

Për cdo të dhënë apo nevojë tjetër në lidhje me kontratën, do të kërkonim mirëkuptimin tuaj për tu paraqitur pranë zyrave tona për tu konsultuar me dokumentet që nuk mund ti përcjellim për arsyen si më lart shpjeguar.

**Faleminderit!**